



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 22. 04. 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani dhe Naser Rugova.

Munguan: Sabri Hamiti dhe Branislav Grbić.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet biocide me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
4. Shqyrtimi i Draftletrës së bardhë - sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë.
5. Caktimi i prioriteteve për shfrytëzimin e buxhetit të paraparë për Komisionin e Integritimeve Evropiane.
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet biocide me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputetin Naser Rugova - referues të këtij projektligji, ta paraqesë raportin lidhur me përputhshmërinë e Projektligjit me *Acquis Communautaire*.

Naser Rugova – Tha se në mbështetje me Divizioni për Standardizim kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe konsideroi se mund të procedohet më tutje dhe duhet të përkrahet edhe nga Komisionet tjera, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis Communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për produktet biocide, me amendamente të Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

4. Shqyrtimi i Draftletrës së bardhë - sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se ka takuar përfaqësues të UNDP-së dhe kanë rënë dakord të formojnë një grup pune për ta përpunuar këtë draft. Njoftoi se nga Kryesia e Kuvendit, Komisioni për Integritet Evropian është caktuar si Komision referues. Theksoi rëndësinë e këtij drafti, sepse pa qenë shtet me stabilitet social, nuk mund të jemi anëtarë të BE-së. Tha se ka edhe fonde globale për luftën kundër tuberkulozit dhe fonde të cilat nuk janë shfrytëzuar nga Kosova.

Hydajet Hyseni - Tha se nuk e kishte të qartë se kush ishte autor i këtij dokumenti. Sa i përket dokumenti jam i zhgënjyer me këtë draft. Ai duhet të jetë model se si nuk duhet të hartohet një dokument. Dokumenti është hartuar sipas përvojës së vendeve të tjera, nuk përputhet me realitetin tonë dhe ka gjuhë të pakuptueshme. Në këtë dokument nuk janë përfshirë çështjet më të ndjeshme sociale, të cilat vihen në pah edhe në Raportin e Progresit, që janë specifika të realitetit tonë, si pensionet, rrënimet e shtëpive të djegur dhe çështja e plaçkitjes së popullsisë.

Kryesuesja – Shtoi se për këtë arsye kam kërkuar të formohet një grup pune dhe ta analizojmë hollësisht këtë draft.

Bujar Bukoshi - U pajtua me vërejtjet e deputetit Hyseni. Tha se është mirë të përqendrohemi në sferat që na interesojnë, sepse ky dokument është shumë i përgjithësuar.

Njomza Emini - U pajtua me vërejtjet e parafolësve. Propozoi të diskutohej për dokumentin, sepse grupi i punës, që do të formohet, do t'i paraqesë propozimet e tyre.

Naser Rugova – Theksoi se e kishte analizuar hollësisht këtë draftdokument. Shtoi se Letra e bardhë ka qenë udhërrëfyes për adresimin e sfidave sociale dhe të sfidave të tjera të shoqërive posttransitore. Në këtë draft citohen edhe vërejtjet që dalin nga Raporti i fundit i Progresit dhe janë shumë të rëndësishme për ne. Kuvendi duhet t'i adresojë këto probleme që dokumentet me rëndësi dhe orientimet politike kombëtare t'u përgjigjen problemeve serioze. U pajtua me vërejtjet e parafolësve lidhur me këtë dokument. Shtoi se ka edhe mospërputhje në cilësinë dhe në radhitjen e prioriteteve. Shihet se ka vonesë në hartimin e raportit për Planin e veprimit. Kërkoj angazhim serioz, pasi siç tha, Komisioni për Integritet Evropian është shumë i rëndësishëm dhe i përfshin të gjitha fushat sektoriale, siç janë të gjitha ligjet për harmonizim me *Aquis Communautaire*.

Fatmir Rexhepi - E kemi pasur më parë një letër të bardhë për privatizimin, por nuk e kemi arritur atë që e kemi synuar. Nga titujt e kësaj letre u frikësua. Ky dokument nuk ka tekst të

mirë, por për hartuesit është i paguar shumë mirë. Ne mund të hapim debat në seancë për pika të caktuara, por gjithnjë në marrëveshje me Qeverinë. Nga ai debat do të dalin rekomandime për atë çështje. Konsideroj se do të ishte e tepërt po të diskutohej, në të njëjtën kohë, për të gjitha këto tema, që janë të përfshira në këtë dokument. Sot nuk është e vështirë të paraqesësh kopje të statistikave dhe të të dhënave. Propozoi që këto tema të shtrohen në marrëveshje me Qeverinë. Është Programi qeveritar që ka objektiva, në bazë të të cilave do të duhej të angazhoheshim. Nuk duhet të përkrahet patjetër nga Komisioni çdo nismë që merret nga dikush tjetër. Nëse vlerësojmë se si Komisioni kemi të drejtë ta nisim një çështje të caktuar për të debatuar në seancë, jam për atë që t'i ndërmarrim t'i gjitha veprimet dhe t'i nxjerrim rekomandimet për atë çështje, por jo të përfshihen të gjitha.

Kryesuesja – Tha se ky draft është hartuar, duke u bazuar edhe në objektivat e mijëvjeçarit. Kryesia e ka caktuar Komisionin për Integritet që të jetë Komision referues.

Edita Tahiri – Shtoi se dokumenti bëhet sipas një standardi. Shpesh për të nuk merren parasysh specifikat, të ngjashme me vendet në tranzicion, që kanë indikatorë socialë të pafavorshëm dhe përpjekje për ta avancuar këtë çështje. Specifikat e vendit tonë fare nuk figurojnë në dokument. Propozoi që kjo çështje të shqyrtohet në grup të punës dhe të nxirren rekomandime në bazë të propozimeve të deputetëve. Në këtë dokument për Kosovën të përfshihet kreu, në të cilin merret parasysh realiteti i Kosovës dhe kreu për luftën në Kosovë.

Naser Rugova – Në këtë draft përmenden konflikti dhe efektet e tij, kurse te shëndetësia përmenden personat me sindromin posttraumatik. Shtoi se Deklarata e mijëvjeçarit e detyron secilin kuvend t'i adresojë objektivat që i kemi votuar. Këto dokumente në vendet e tranzicionit i ka hartuar UNDP-ja. Dokumenti i hartuar për Kosovën, ka përmasa sociale të fokusgrupeve të caktuara dhe krijon raporte dhe shifra konkrete. Statistikat e përfshira në këtë dokument janë të sakta, por ka edhe statistika të viteve të kaluara, që nuk korrespondojnë me ato të këtij viti. Propozoi të koncentrohen më shumë në redakturën e tekstit dhe në radhitjen e prioriteteve që të jepen rekomandime për Letrën e bardhë.

Hydajet Hyseni - Tha se në këtë dokument ka brumë, por defekti qëndron se u është përmbajtur standardeve dhe nuk u është përshtatur specifikave tona. Janë mbështetur në specifikat tona, por jo në specifika të sakta. Janë përfshirë edhe disa kategori të përjashtuara, që nuk janë përjashtuar, kurse nuk janë përfshirë kategori shumë të rëndësishme. Propozoi të punohet në bazë të këndvështrimit të Komisionit në bashkëpunim me UNDP-në, në mënyrë që të përpunohet ky tekst.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Grupi i punës për përpunimin e Draftletres së bardhë - Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë, do të përbëhet nga deputetët: Zylfije Hundozi, Hydajet Hyseni, Naser Rugova, Edita Tahiri dhe Bujar Bukoshi.

5. Caktimi i prioriteteve për shfrytëzimin e buxhetit të paraparë për Komisionin e Integriteteve Evropiane

Kryesuesja – Tha se e ka caktuar të diskutohet për këtë pikë, meqë kur është interesuar për mënyrën e shfrytëzimit të buxhetit, që e kanë caktuar për Komisionin tonë, kanë kërkuar të paraqesim parallogari si e kemi planifikuar t'i shpenzojmë ato të holla. Parallogaria do të dorëzohet për t'u diskutuar në Kryesi. Pastaj mund t'i tërheqim të hollat për realizimin e planeve të parapara. Kërkoj nga deputetët t'i propozojnë aktivitetet që duhet t'i realizojnë.

Edita Tahiri - Propozoi të përcillen në mënyrë të organizuar seancat e Parlamentit Evropian, që do të mbahen në shtator dhe në nëntor.

Nait Hasani - Duke e pasur parasysh rëndësinë e Komisionit, buxhet është shumë i vogël. Propozoi të trefishohet buxheti i Komisionit për Integritet Evropian. Shtoi se duhet t'i kemi parasysh edhe rastet kur presim delegacione nga vendet e tjera. Ne, brenda Kuvendit, nuk kemi sallë, në të cilën do të mund të presim delegacione, andaj duhet të kemi buxhet më të madh se komisionet e tjera.

Dzezair Murati – E përkrahu diskutimin e parafolësit se buxheti i dedikuar për Komisionin për Integritet, nuk mjafton. Tha se ky Komision, me Komisionin për Punë të Jashtme, i kanë specifikat e veta, sepse duhet të realizojnë vizita jashtë shtetit dhe të ftojnë delegacione për të na vizituar. Buxheti paraqet një shumë simbolike, por tani është vonë, sepse buxheti i vitit 2009 është miratuar. Ne si Komision është dashur me kohë t'i bënim propozimet për rritjen e tij. Njoftoi se Kryesia nuk mund të vendosë tani, sepse ajo vendos vetëm për mjetet e gatshme. Propozimin për rritjen e buxhetit mund ta bëjmë, kur propozohet buxheti, sepse procesi i njohjeve varet shumë edhe nga kontaktet me shtetet e ndryshme. Atë çka mund ta bëjmë për përmirësimin e gjendjes financiare, është të kërkojmë donacione nga donatorët e ndryshëm për realizimin e vizitave.

Hydajet Hyseni – Tha se ka mundësi të rishikohet buxheti dhe duhet të bëhet një kërkesë për rishikim. Sa u përket vizitave, të cilat duhet të bëhen, mund të kërkojmë mbështetje shtesë nga Kuvendi dhe nga donatorët. Kërkoj që kryesuesja ta paraqesë ndonjë propozim lidhur me prioritetet, pastaj propozimet të diskutohen në Komision.

Naser Rugova - Propozoi të mos shpenzohen këto të holla para rishikimit të buxhetit. Kërkoj të hartohet një agjendë e Komisionit si të shpenzohen këto mjete deri në mesin e qershorit dhe në rishikim të bëhet kërkesë konkrete. Për muajt shtator - dhjetor do të mund të nxirrim para të tjera, por me një propozim konkret.

Pas diskutimeve u nxor ky

Përfundim

Kryesuesja të kontaktojë me personat përgjegjës dhe të njoftohet më hollësisht për procedurat e shfrytëzimit të buxhetit të paraparë për Komisionin për Integritet.

Të ndryshme

a) Mosardhja e ministrave në mbledhjet e Komisionit

Bujar Bukoshi - Tha se ishte paraparë që në këtë mbledhje të raportojë ministrja e Drejtësisë. Kërkoj të dijë pse nuk merr pjesë ministrja në këtë mbledhje. Po ashtu kërkoj të ftohet ministri i ekonomisë që të raportojë në Komision.

Kryesuesja - Njoftoi se ministrja nuk i ishte përgjigjur ftesës për të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit me arsyetimin se ishte shumë e zënë. Shtoi se në konferencën që e kishim me eurodeputët na thanë se Qeveria po e cakton agjendën dhe kërkuan nga ne t'i ftojme sa më shumë ministrat për raportim para komisioneve.

Edita Tahiri - Propozoi të hartohet një letër për Kryesinë e Kuvendit, për kryetarin e Kuvendit dhe për kryeministrin që ta dinë cili është qëndrimi i Qeverisë ndaj Kuvendit, sidomos ndaj komisioneve. Po ashtu ta dinë a janë ministrat të detyruar t'u përgjigjen ftesave të komisioneve apo mund të vendosin a do t'u përgjigjen. Jam e mendimit që këtë çështje ta bëjmë publike pasi

të merret përgjigjja. Kjo do të ndihmonte në vetëdijesimin e dy ministrave, të cilët nuk iu përgjigjën ftesave të Komisionit, por edhe parandalon dukuritë që mund të përsëriten.

Hydajet Hyseni - Njoftoi se ka biseduar me ministrin e Financave. I ka thënë se në mbledhjen ishte i pranishëm zv.ministri, sepse ministri Ahmet Shala gjendej në udhëtim jashtë vendit. Shtoi se ministri ka shprehur gatishmëri të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit. Lidhur me kritikën të cilën e adreson Raporti i Progresit, që po e dëgjoj shpesh, ka të bëjë me caktimin e agjendës së Kuvendit nga ana e Qeverisë. Praktika më e mirë është kur Qeveria me dokumente e cakton agjendën e Kuvendit. Kritika ime lidhet me atë se nuk po furnizohemi sa duhet me ligje, me dokumente dhe me raporte, duke u bazuar në mandatin të cilin ia kemi dhënë, andaj kjo duhet të rishikohet.

Nait Hasani - Tha se deri tani ministri i Ekonomisë çdo herë e ka konfirmuar ardhjen, mirëpo asnjëherë nuk ka ardhur. Propozoi që në rastet, kur nuk vijnë ministrat në Komision, anëtarët e Komisionit të shkojnë në Ministri dhe të takohen me ta.

Pas diskutim u nxor ky

Përfundim

Deputeti Bukoshi mori përsipër të bisedojë me ministren e drejtësisë, Nekibe Kelmendi, në mënyrë që të shqyrtohet mundësia e raportimit të ministres në Komision.

b) Caktimi i pjesëmarrësve për takimin në Slloveni

Naser Rugova - Tha se për hir të kolegjalitetit tërhiqet nga udhëtimi i parë, në mënyrë që të krijohet një rreth i përfaqësimit të opozitës në vizitat të cilat do të organizohen.

Nait Hasani - Kërkoi të marrin pjesë me mjete financiare organizatat që e mbështesin Komisionin, në mënyrë që Komisioni t'i realizojë vizitat në përbërje të plotë.

Pas debateve të deputetëve u nxor ky

Përfundim

Në udhëtimin në Slloveni do të marrin pjesë këta deputetë: Zylfije Hundozi, Fatmir Rexhepi, Nait Hasani, Njomza Emiri dhe Edita Tahiri.

c) Përgatitja e raportit për PVPE-në

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se vetëm Komisioni për Shërbime Publike, Media dhe Administratë Lokale i ka dorëzuar vërejtjet dhe propozimet lidhur me PVPE-në. Për t'u marrë propozime dhe raporte nga të gjitha komisionet, ia kam drejtuar një shkresë Kryesisë që të kërkojë nga Komisionet t'i paraqesin raportet lidhur me veprimet e ndërmarra për përmbushjen e PVPE-së.

Mbledhja përfundoi në 12:45 min.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesje e Komisionit

Zylfije Hundozi

